



Republika e Kosovës – Republic of Kosovo
Komuna Hani i Elezit- Municipality of Elez Han



02Nr. 6748 /2025
21.08.2025

Në bazë të Ligjit për Zyrtarët Publikë Nr.08/L-197 në nenin 78 paragrafi 2, neni 80 dhe 81, Ligjit për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës Nr.03/L-068 neni 5 pika c, Ligjit të Punës Nr.03/L-212 neni 8 Udhëzimit Administrativ të MASHT-it Nr.05/2021 dhe 01/2022, Për Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm, Rregullore (QRK) nr.19/24 Për procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit të drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve, mësimitdhënësve, bashkëpunëtorëve profesional, asistentëve, instruktorëve dhe sekretarëve në institucionet publike edukativo-arsimore dhe aftësuese (IEAA) të arsimit parauniversitar, Komuna Hani i Elezit shpallë:

KONKURS

(Për plotësimin e vendit të lirë të punës me kohë të pacaktuar)

Institucioni: Komuna Hani i Elezit

Drejtoria: Drejtoria për Arsim

1. Titulli i vendit të punës: Mësimitdhënës/e i për lëndën Edukatë Fizike dhe mësim zgjedhor njësia/ sektori: SHFMU "Veli Ballazhi"-Gorancë

Numri i pozitave: Një (1) pozitë me kohë të pacaktuar

Koeficienti/Grada: E19-6.60

Orët e punës: 20 orë

Detyrat dhe përgjegjësitë për Mësimitdhënës/e :

Të realizoj planprogramin mësimor për vendin e punës, në harmoni me legjislacionin në fuqi, që të rregullojë fushat përkatëse për vendin e tij/saj të punës;
Të zbatoj detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimitdhënies;
Të përgadit me rregull planin mësimor, në përputhje me Kurrikulën Bërthamë;
Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimitdhënies dhe vlersimit në përputhje me me Udhëzimet Kurikulare;
Të mbajë ditarin personal të vlersimit të nxënësve.
Të marrë pjese aktive në organizimet jashtë mësimore me nxënës;
Të respektoj autoritetin e drejtpërdrejt të zyrtarit, të cilit i raporton dhe ti kryej detyrat që mund ti caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.

Kushtet e përgjithshme në rekrutim:

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës.
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
- Të zotëroj të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët.
- Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse.
- Të mos jetë e/i denuar për kryerjen e veprës penale me dashje.
- Të mos ketë fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik

Kualifikimi për lëndën Edukatë Fizike

- Niveli master arsimor (300 ECTS)
- Sistemi katërvjeçar;
- Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS);

Dokumentet e nevojshme:

- Formulari i aplikimit (merret në Komunë – Qendra për Shërbime me Qytetarë)
- Rezymeja personale (CV).
- Dokumenti personal (letërnjoftim ose pasaportë kopje).
- Diploma e kualifikimit (ose certifikata) duhet të jete kopje të vërtetuara.
- Certifikata që nuk jeni nën hetime (nga gjykata)
- Dëshmi të përvojës në institucione arsimore (nëse ka).
- Çertifikatën shëndetësore (pas pranimi në punë).

Mënyra e vlerësimit dhe kriteret e poentimit:

- Procedura e vlerësimit bëhet sipas Rregullorës (QRK)nr.19/2024.

Afati dhe mënyra e aplikimit:

Pranimi i aplikacioneve bëhet mbrenda tridhjetë (30) ditëve nga data 22.08.2025 deri 20.09.2025 nga ora 08:00-16:00

Të gjithë kandidatët e interesuar aplikacionin e punësimit mund ti marrin në formë fizike pranë Qendrës për Shërbime me Qytetarë në Han të Elezit kati i parë dhe të plotësuar e dorëzojnë në të njëjtin vend, apo ti shkarkojnë në portalin shtetëror <https://konkursi.rks-gov.net>

Dokumentacioni i kandidatëve të cilët nuk i plotësojnë kriteret e konkursit nuk do të shqyrtohen ndërsa në faza tjera do të ftohen vetëm kandidatët që i plotësojnë kriteret e që futen në listë të ngushtë.

T ë gjithë kandidatët të cilët kanë mbaruar studimet, jashtë Shtetit të Republikës së Kosovës, e që konkurrojnë për këto pozita, duhet që diplomat e tyre (gradat universitare të fituara) të jenë të njohura (nostrifikuara) nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në pajtim me Udhëzimin Administrativ, nr.12/2018 të datës 10.09.2018, në të kundërtën komisioni gjatë selektimit të aplikacioneve, do të refuzoj çdo aplikacion të kandidatëve të cilët nuk e kanë plotësuar këtë kusht të konkursit.

Mirë priten aplikacionet e femrave dhe meshkujve të të gjitha komuniteteve të Republikës së Kosovës

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

Konkursi dhe rezultatet shpallen në linkun: <https://konkursi.rks-gov.net/>, në web faqen e komunës <https://hannielezit.rks-gov.net/> në tabelën e shpalljes.

**Kryetari i Komunës
Mehmet Ballazhi**

